
Mbrojtja e Kafshëve të Rrezikuara në Kosovë

Analizë Politikash

04/2019



Mbrojtja e Kafshëve të Rrezikuara në Kosovë

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Zhvillim i qëndrueshëm**

Publikimi: **Prill 2019**

Foto e ballinës: **Unsplash**



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



**Rockefeller
Brothers
Fund**

Ky punim është publikuar me mbështetjen e Fondit të Vëllezërve Rockfeller. Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

Përmbajtja

Hyrje	1
Baza Ligjore dhe Institucionale.....	2
Mungesa e të dhënave.....	4
Monitorimi i zbatimit të ligjit.....	5
Financimi	5
Rritja e vetëdijës.....	5
Rekomandimet	6

Hyrje

Prilli i vitit 1970 mblodhi një numër të madh njerëzish të pakënaqur me efektet negative mjedisore që po vinin si rezultat i revolucionit industrial. Çështjet si përkeqësimi i shëndetit të njerëzve, sidomos fëmijëve, rënia e biodiversitetit, smogu, etj., shtynë që shumë shtete të ndërmerrnin politika që kontribuan në rritjen e vetëdijes ekologjike globale. Nga kjo lëvizje u krijuan edhe shumë agjenci dhe akte, si p.sh. Environmental Protection Agency dhe Clean Water Act në Amerikë. Për më tepër, kjo lëvizje përcaktoi 22 prillin si Ditë Ndërkombëtare të Tokës, e cila shënohet në baza vjetore nga më shumë se 192 shtete nëpër botë, aktivitetet e të cilave vlerësohet të mbledhin afro 1 miliardë persona¹. Edhe pse jo në numër të madh, edhe Kosova ka organizuar disa aktivitete në të kaluarën për të shënuar këtë ditë.

Aktivitetet e ndryshme ekonomike të njerëzve ndër vite kanë shkaktuar një disbalancë në natyrë e cila po shpie Tokën drejt një shkalle të lartë të zhdukjes së specieve të ndryshme. Këto shkallë e madhe e zhdukjes së specieve vjen si rezultat i ndryshimeve klimatike, eksploatimi i burimeve natyrore, shpyllëzimit, humbja e habitateve të ndryshme, trafikimi dhe gjuetia ilegale, bujqësia e paqëndrueshme, ndotja e burimeve jetësore, përdorimi i pesticideve, etj². Për këtë arsye, Rrjeti i Ditës së Tokës ka zgjedhur si temë diskutim për 22 prillin e këtij viti speciet e rrezikuara.

Të gjitha gjallesat kanë rolin e vet të veçantë në zinxhirin jetësor të planetit Tokë. Që të

¹Rrjeti i Ditës së Tokës, (2019), Për ditën e Tokës, i qashëm në <https://www.earthday.org/earthday/>

²<https://www.earthday.org/campaigns/endangered-species/earthday2019/>

kemi një ekosistem me biodiversitet sa më të balancuar duhet që çdo specie të luaj rolin e saj në të cilin rol speciet e tjera bazohet për të jetuar dhe vazhduar ofrimin e shërbimeve për zinxhirin jetësor³. Për këtë arsye, ekosistemet komplete dhe të shëndetshme janë më produktive dhe rezistente ndaj shkatërrimit.

Pasojat që vijnë me humbjen e qoftë vetëm një specie ndikojnë në zinxhirin ushqimor që ndikon negativisht në speciet e tjera dhe ekosistemin në përgjithësi, ngadalëson/rrezikon pllenimin, humbet pasuritë terapeutike që jep natyra, shkatërron industritë të cilat bazohen në produktet që vijnë nga kafshëve (si p.sh. mjalta), etj.

Botërisht, speciet më të rrezikuara të cilat mund edhe të zhduken përgjithmonë,




Figura 1. Aktivitetet që ndikojnë tek speciet e zogjve

konsiderohen të jenë: bletët, koralet ujore, elefantët, gjirafat, insektet, balenat, etj. Vetëm për 40 vite, planeti Tokë ka humbur 40% të biodiversitetit të tij⁴. Një në tetë lloje zogjsh është i kërcënuar me zhdukje si

³Cho, Renee. (2019). 'Why endangered species matter'. Earth Institute, Columbia University. <https://phys.org/news/2019-03-endangered-species.html>

⁴Carrington, Damian. (2014). The Guardian. Par. 12. <https://www.theguardian.com/environment/2014/sep/29/earth-lost-50-wildlife-in-40-years-wwf>

rezultat i faktorëve të lartpërmendur, që do të thotë 40% nga 11,000 lloje zogjsh që janë në tokë janë në rënie e sipër⁵. Bujqësia e cila luan mjaftueshëm rol në zhdukjen e zogjve rrezikon 1,469 specie zogjsh. Më poshtë mund të shihni përqindjen e rrezikut për zhdukje të zogjve nga aktivitete të ndryshme që njerëzit ndërmarrin në tokë.

Bazuar në të dhënat statistikore të Listës së Kuqe të Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN-së), botërisht, rreth 26,500 specie janë në rrezik për zhdukje nga të cilat 40% përfshijnë amfibet, 34% halorët, 33% koralet ujore, 25% gjitarët, dhe 14% zogjtë⁶. Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) është organizatë ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes dhe konzervimit të natyrës, dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Vetëm ditë më parë, më 16 Prill, Kosova mori titullin e anëtarës në këtë mënyrë hyn në forum i cili përfshin qeveritë, sektorin e shoqërisë civile, organizatat e popujve indigjenë, shkencëtarët, bizneset, komunitetet lokale, e shumë akterë të tjerë relevant të cilët mund të dizajnojnë dhe implementojnë politika mjedisore të qëndrueshme⁷.

Kur vjen fjala tek cenimi i vlerave që përqon biodiversiteti dhe natyra në përgjithësi, edhe Kosova nuk përjashtohet nga ky rrezik me

⁵ 'Forty Percent of the World's Bird Populations Are in Decline, New Study Finds'. (2018). Yale Environment 360. <https://e360.yale.edu/digest/forty-percent-of-the-worlds-bird-populations-are-in-decline-new-study-finds>

⁶ Cho, Renee. (2019). 'Why endangered species matter'. Earth Institute, Columbia University. <https://phys.org/news/2019-03-endangered-species.html>

⁷ IUCN welcomes Kosovo as its newest Member. (2019). https://www.iucn.org/news/secretariat/201904/iucn-welcomes-kosovo-its-newest-member?fbclid=IwAR3wicN_PUJxDCsGIJzH8zr9V DuiFgqLiZTZtxbj6hw0ZVzlw0K0qmDyxhA

të cilin po përballen edhe vendet e tjera të botës. Për shkak të pozitës gjeografike të favorshme të Kosovës, biodiversiteti është mjaftë i larmishëm; numri më i madh i specieve mund të gjenden në zonat e Maleve të Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna⁸.

Rrjeti kombëtar të zonave të mbrojtura, në të cilat bëjnë pjesë edhe këto dyja, përfshin 97 zona të natyrës, e cila përbën 4.39% (47,842.34 ha) të të gjithë territorit të Kosovës⁹. Deri më tani, vlerësohet se Kosova ka afro 250 lloje të egra të kurrizorëve, 180 lloje të shpezëve, 130 lloje të insekteve, 45 lloje të gjitarëve, etj¹⁰. Sa i përket numrit të shtazëve strikt të mbrojtura, figura 2 tregon numrin e secilit lloj ndaras.

Sidoqoftë, shkalla e lartë e rrezikshmërisë për kafshët në zhdukje mund të ngadalësohet nëse organet kompetente qeveritare punojnë ngushtë me qytetarët, sektorin privat dhe shoqërinë civile. Në pjesën e fundit të këtij shkrimi, mund t'i gjeni edhe disa rekomandimet konkrete që INDEP propozon për t'u implementuar në lidhje me mbrojtjen e kafshëve në rrezik në Kosovë.

Baza Ligjore dhe Institucionale

Baza ligjore që rregullon fushën e mbrojtjes së kafshëve buron nga Kushtetuta e vendit, ligjet e veçanta dhe aktet nënligjore. Kushtetuta e Republikës së Kosovës specifikon qartë:

⁸'Biodiversiteti i Kosovës'. (2013). Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Biodiversiteti_i_Kosoves.pdf

⁹ 'Disa Fakte mbi Mjedisin 2018'. (2019). Agjencia e Statistikave të Kosovës. <http://ask.rks-gov.net/media/4650/disa-fakte-mbi-mjedisin-2018.pdf>

¹⁰ Ibid.

Pasuritë natyrore, si ujërat, hapësira ajrore, pasuritë minerare dhe pasuritë e tjera natyrore, si dhe trualli, pyjet, bota bimore e shtazore, pjesët e tjera të natyrës, paluejtshmëria dhe të mirat e tjera me rëndësi të veçantë kulturore, historike, ekonomike dhe ekologjike, të cilat përcaktuar me ligj se janë përcaktuar me interes për Republikën e Kosovës, gëzojnë mbrojtjen e tyre të veçantë, në pajtim me ligjin.¹¹

Pra, Kushtetuta përcakton se për botën bimore dhe shtazore do të ketë mbrojtje të veçantë ligjore. Për këtë baza aktuale ligjore mbron kafshët nga zhdukja dhe përcakton

kornizat kryesore për zbatimin e mbrojtjes ligjore për speciet në zhdukje.

Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës është ligji bazë që përcakton kornizat për mbrojtjen e kafshëve në Kosovë. Ky ligj përcakton se “Nuk lejohet zhdukja e llojeve të egra vendore”.¹²

Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës gjithashtu përcakton edhe llojet e mbrojtura të zonave dhe vlerave të mbrojtura.

1. Vlerat e mbrojtura të natyrës sipas këtij ligji janë:

1.1. zonat e mbrojtura:

1.1.1. rezervati strikt i natyrës;




Figura 2. Numri i kafshëve të mbrojtura në Kosovë. Burimi: MMPH

¹¹ Republika e Kosovës, (2008), Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 122.2 – Përdorimi i pasurisë dhe Burimeve Njerëzore, Prishtinë: GZRKS.

¹² Republika e Kosovës, (2010), Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, Neni 86.3 – Mbrojtja dhe ruajtja e llojeve të egra, Prishtinë: GZRKS.

- 1.1.2. parku kombëtar;
 - 1.1.3. zonë e veçantë – ZVM dhe ZVR;
 - 1.1.4. park natyre;
 - 1.1.5. monument natyre;
 - 1.1.6. peizazh i mbrojtur;
 - 1.1.7. monument i arkitekturës së parkut.
- 1.2. llojet e mbrojtura:
- 1.2.1. lloj i egër strikt i mbrojtur;
 - 1.2.2. lloj i egër i mbrojtur;
 - 1.2.3. lloj i zbutur vendor i mbrojtur.
- 1.3. mineralet, shtresimet dhe fosilet e mbrojtura.
2. Vlerat e mbrojtura të natyrës renditen në shkallë të rëndësisë:
- 2.1. ndërkombëtare;
 - 2.2. kombëtare;
 - 2.3. lokale¹³

Të gjitha këto elemente ligjore janë të mbështetura në bazë të Direktivës së Habitaveve.¹⁴ Për më tepër, institucionet e Kosovës kanë hartuar Udhëzimin Administrativ 18/2012 për Shpalljen e Llojeve të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura. Ky udhëzim përbën bazën kryesore ligjore e cila drejtëpërdrejt u ofron mbrojtje llojeve të caktuara të kafshëve.

¹³ Ibid.

¹⁴ Direktiva e BE-së e Habitaveve synon mbrojtjen e llojeve të specieve të rrezikuara nga zhdukja.

Udhëzimi mbulon të gjitha kafshët që janë pjesë edhe e Direktivave evropiane Megjithatë, udhëzimi qartëson se:

Masat për ruajtjen e llojeve të egra të mbrojtura dhe strikt të mbrojtura, do të zbatohen vetëm për ato lloje që gjenden në Republikën e Kosovës, migrojnë ose rrugët migratore të tyre kalojnë nëpër Republikën e Kosovës.¹⁵

Në bazë të listës, janë mbi 1200 lloje të shtazëve strikt të mbrojtura në Kosovë. Megjithëse baza ligjore ekziston, zbatimi i saj çalon. Në fakt, mungojnë të dhëna edhe për të konstatuar nivelin e zbatimit të bazës ligjore.

Mungesa e të dhënave

Mbrojtja e llojeve të rrezikuara të shtazëve siç e pamë është prioritet i bazës ligjore në Kosovë. Megjithatë, mungojnë mekanizma të matjes së saktë të gjendjes aktuale dhe nivelit të zbatimit të saj.

Në nivel të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ekziston Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në portfolio të së cilit është edhe kryerja e analizave statistikore dhe mbledhja e të dhënave. Megjithatë, nuk ka të dhëna sa i takon numrit të shtazëve të mbrojtura dhe popullacionin e tyre në Kosovë.

Mungesa e të dhënave është e dukshme edhe në Agjencinë e Statistikave të Kosovës. Kjo agjenci, e thirrur ligjërisht për të prodhuar të dhëna zyrtare, nuk ka të dhëna sa i takon numrit të shtazëve të mbrojtura dhe strikt të mbrojtura dhe gjendjen e tyre në natyrë. Për më tepër, edhe mekanizmat ndërkombëtar kanë alarmuar se nuk është

¹⁵ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, (2012), Udhëzim Administrativ Nr. 18/2012 për Shpalljen e Llojeve të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura, Prishtinë: MMPH.

bërë asnjë inventarizim i biodiversitetit¹⁶ që përbën bazë e çfarëdo planifikimi të politikave publike në këtë fushë.

Monitorimi i zbatimit të ligjit

Fusha e mbrojtjes së kafshëve në rrezik është e patrajtuar nga diskursi publik dhe institucional. Baza ligjore është kompletuar me inercion nga procesi i përafrimit të legjislacionit me Bashkimin Evropian, por nuk ka presion institucional dhe publik për zbatimin e saj.

Kuvendi i Kosovës ka mundësinë të bëjë një monitorim të detajuar të zbatimit të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës. Monitorimi i zbatimit të Ligjit do të mundësonte hapjen e një debati fillimisht ndër-institucional e pastaj ndërshoqëror për priorizimin e mbrojtjes së shtazëve të egra.

Monitorimi i këtij ligji është bërë nga organizata joqeveritare mirëpo monitorimi nga ana e Komisionit parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor do të kanalizonte në rrugë institucionale të gjitha problemet në lidhje me zbatimin e ligjit.

Financimi

Aktualisht, nuk ka ndonjë skemë të financimit për mbrojtje, shtim dhe ruajtje të biodiversitetit. Mungon prioritizimi si në nivelin komunal ashtu edhe në at qendror. Kjo sepse në njërin anë mungon vetëdija institucionale për rëndësinë e ruajtjes së habitateve natyrore por edhe mungon

vizioni për të shfrytëzuar ekonomikisht biodiversitetin.

Në komuna, financimi i projekteve të ruajtjes dhe konservimit të natyrës kryesisht u atribuohet donatorëve. Prioritet kryesor i komunave janë investimet infrastrukturore dhe jo projektet e mbrojtjes së mjedisit. Edhe institucionet qeveritare investojnë nëpër komuna kryesisht në projekte infrastrukturore.

Investimi në biodiversitet duhet parë edhe si investim në turizëm, në ruajtje të florës dhe faunës dhe në rritjen e mirëqenies së botës së gjallë në përgjithësi, përfshirë njerëzit.

Rritja e vetëdijës

Ruajtja e mjedisit kërkon rritje të vetëdijës dhe informimit të përgjithshëm. Përveç integritetit të temës së mbrojtjes së kafshëve në korrikulën arsimore, duhet bërë më shumë në vetëdijësimin e shoqatave të gjuetarëve dhe qytetarëve në përgjithësi.

Qeveria në nive të institucioneve të sigurisë, arsimit dhe mjedisit, ende nuk kanë hartuar një strategji të përbashkët në atë mënyrë që të koordinohen përpjekjet. Qytetarët para marrjes së lejes për armë nuk marrin ndonjë trajnim të veçantë për kafshët e mbrojtura. As gjuetarët përmes shoqatave të tyre nuk marrin informata para çdo sezone dhe informata të rregullta në lidhje me kafshët e mbrojtura, zonat ku gjenden etj.

Ministria mban në një udhëzim një listë prej qindra kafshësh të mbrojtura të shënuara me emra latin dhe nuk ka ndonjë përpjekje për ta plasuar informatën më thjeshtë tek qytetarët. Në uebfaqen e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit nuk ka ndonjë vegzë të veçantë për shtazët e mbrojtura në Kosovë. Madje, uebfaqja e

¹⁶ Banka Botërore, (2011), Analiza mjedisore e shtetit- Vlerësimi i kostos së degradimit mjedisor, rishikimi institucional dhe rishikimi i shpenzimeve publike për mjedisin, Prishtinë: WB e qasshme në http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/Resources/KosovoCEA_Alb.pdf (qasur në prill, 2019).

kësaj të fundit as nuk funksionon fare.¹⁷ Informimi dhe vetëdijësimi i qytetarëve duhet shndërruar në prioritet në mënyrë që kërkesat për mbrojtje të kafshëve të vinë nga poshtë lart dhe të gjithë qytetaërt të marrin pjesë në përpjekjen për të ruajtur speciet dhe për të mbrojtur habitatet e kafshëve në rrezik.

Rekomandimet

- Agjencia e Statistikave të Kosovës, Qeveria dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor urgjentisht të punojnë në krijimin e një baze të të dhënave për llojet e specieve të rrezikuara në Kosovë dhe të kompletojnë inventarizimin e biodiversitetit në Kosovë. Të dhëat duhet të rënditen me fusha dhe indikatorë të krahasueshëm në baza të rregullta dhe të jenë të hapura e transparente për publikun.
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të punoj ngusht me komunat e Kosovës në mënyrë që të rritet bashkëpunimi ndërinstitucional dhe të sigurohet zbatimi i bazës ligjore. Përveç kësaj, në nivel të Asociacionit të Komunave të Kosovës duhet gjetur mënyra për të adresuar mungesën e mekanizmave institucional në nivel komunal. Ndonëse komunat nuk kanë buxhet për të formuar drejtori të reja, nevojitet së paku një zyrë e unifikuar për mbrojtje të natyrës dhe biodiversitetit.
- Komisioni parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim

Hapësinor duhet të bëjë monitorimin e Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës. Monitorimi i zbatimit të Ligjit i paraprin një debati shoqëror shumë të nevojshëm në lidhje me rëndësinë e mbrojtjes së kafshëve.

- Komunat të krijojnë linja të veçanta buxhetore për ruajtjen e biodiversitetit dhe ruajtjes së kafshëve të mbrojtura. Në këtë drejtim, Qeveria duhet të asistoj me fonde për financimin dhe bashkëfinancimin e projekteve të komunave.
- Institucionet, me theks të veçantë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duhet të hartojnë strategji dhe kampanja informuese për qytetarët në lidhje me ruajtjen e kafshëve të mbrojtura. Trajnime të rregullta duhet të mbahen me shoqata të gjuetarëve si dhe duhet t'u shpërndahen materiale vetëdijësuese gjatë marrjes së lejes për gjueti si dhe para çdo sezoni të gjuetisë.

¹⁷ 22 prill, 2019.

